D E K R E T
Nr.913, datë 25.8.1994

PËR NJË SHTESË NË DEKRETIN NR.7393, DATË 12.6.1990 "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE PËR JASHTË SHTETIT DHE DHËNIEN E VIZAVE"

Në mbështetje të nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J

Neni 1

Në dekretin nr.7393, datë 12.6.1990, ndryshuar me dekretin nr.528, datë 30.4.1993, në nenin 17, në paragrafin ku parashikohet dhënia e vizave në kufi për shtetasit e Egjiptit dhe vendeve Arabe të shtohen dhe shtetasit izraelitë dhe ky paragraf të ndryshohet si më poshtë:

"Shtetasve egjiptianë, sauditë, të Emirateve të Bashkuara, Kuvajtit, Omanit, Katarit, Bahreinit dhe Izraelit, të cilët e vërtetojnë këtë me dokumente, t'u jepet viza nëpër pikat tona kufitare.

Taksa e vizës të merret në bazë të reciprocitetit".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDERFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKES
Sali Berisha